



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 107 prot.

Tiranë, më 18 . 01 . 2024

V E N D I M

Nr. 20 , datë 18 . 01 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 167 Regj., datë 14.09.2023³, të grupit të personave/mjekë specialistë mikrobiologë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), kundër Këshillit të Ministrave, me pretendimin e diskriminimit nga VKM nr. 245, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr. 555, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë Përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësine Mjekësore Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin Përkatës”, të ndryshuar, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, të cilët bëjnë pjesë në grupin e mjekëve mikrobiologë, të atashuar pranë NJVKSH-ve, në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, ndër të tjera, kanë parashtruar se:

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Plotësuar dhe saktësuar nga subjekti ankues nëpërmjet e-mailit datë 29.09.2023.

⁴ Si pjesë e grupimit të mjekëve specialistë mikrobiologë, të atashuar prane NJVKSH-ve.

“Ne jemi një grup mjekësh mikrobiologë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Sipas VKM nr. 245, datë 20.04.2023, të gjithë mjekët specialistë janë trajtuar me një rritje page prej 50.000 lekësh për pozicionin e punës, me përjashtim të mjekëve mikrobiologë, pranë NJVKSH-ve.

Bazuar në VKM-në sipërcituar, vihet re, që mjekët me specialitet afatgjatë për mikrobiologji, të cilët janë emëruar nga Ministria e Shëndetësisë pranë NJVKSH-ve, nuk janë të specifikuar në asnjë nga strukturat dhe nivelet e pagave të parashikuara në këtë Vendim, sikundër është vepruar për rastet ku institucionet kanë në strukturë mjekë me specialitet dhe mjekë të përgjithshëm.

Bazuar në Udhëzimin nr. 8, datë 24.04.2023, të Ministrisë së Shëndetësisë për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) janë kategorizuar strukturat e Qendrave Shëndetësore, ku përmendet si pjesë e tyre dhe mjeku mikrobiolog, por në të gjithë Qendrat Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, nuk ekziston asnjë Laborator Mikrobiologjik apo mjek mikrobiolog i punësuar, e nga ana tjetër, në VKM nr. 245/2023, nuk është kategorizuar struktura e NJVKSH-ve, ku në rang kombëtar ekzistojnë 36 NJVKSH, ku secila ka Laborator Mikrobiologjik.

Mjeku mikrobiolog i përket kategorisë së Mjekut Specialist, i cili ka kryer specializim afatgjatë pasuniversitar pranë Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, në përfundim të të cilit është titulluar “Mjek Specialist Mikrobiolog” dhe është pajisur me diplomë specializimi.

Detyra që ne kryejmë i takon Shërbimit Shëndetësor Komunitar, që lidhet drejtëpërdrejtë me pacientin/popullatën, e cila finalizohet me një përgjigje përfundimtare, e cila mban vulën e mjekut mikrobiolog. Kjo është një detyrë që nga ana procedurale nuk mund ta kryejë asnjë mjek tjetër. Duhet cilësuar se laboratorët mikrobiologjikë të NJVKSH-ve janë të vetmet që ofrojnë shërbimin ambulator për diagnozën e sëmundjeve infektive.

Na lind e drejta që, si mjekë specialistë mikrobiologë të kërkojmë të trajtohem njësoj si mjekët e tjerë specialistë, pasi në gjykimin tonë jemi lënë në harresë dhe të diskriminuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj pranë Komisionerit subjekti ankues/grupi i personave, mjekë specialistë mikrobiologë pranë NJVKSH-ve, ka kërkuar të konstatohet diskriminimi kundrejt këtij grupi të veçantë nga Këshilli i Ministrave, si dhe të rishikohet VKM nr. 245, datë 20.04.2023, sa i takon kategorizimit të tyre, në grupin e mjekëve specialistë që përfitojnë një rritje page prej 50.000 lekësh për pozicionin e punës, duke u trajtuar në mënyrë të barabartë me ta.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës të bërë nga grupi i mjekëve mikrobiologë, pranë NJVKSH-ve, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1007/1, datë 26.09.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti kundrejt të cilit është paraqitur ankesa, Këshilli i Ministrave, si dhe subjektet e tjera që janë të përfshira apo mund të ndihmojnë me informacionin e tyre KMD-në, si: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë (UMSH) dhe Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (SPSHSH), lidhur me pretendimet e subjekteve ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - “Parashtrime lidhur me pretendimet e subjekteve ankues.
 - Kopje të Relacionit shoqërues të këtij Vendimi, objekt shqyrtimi pranë KMD-së.

- Nëse ka, apo do ketë (brenda një afati të arsyeshëm kohor) masa të ndërmarra nga ana juaj, në kuadër të konsiderimit e zgjidhjes së kësaj problematike, lutemi të na vini në dijeni, duke bashkëlidhur dhe dokumentacionin respektiv.
 - Bashkëlidhur mund të depozitoni çdo dokument tjetër që vlerësoni se ndihmon në sqarimin apo zgjidhjen e problematikës së ngritur.”
- Në vijim të kërkesës së KMD-së, me shkresën nr. 110/1 prot, datë 02.10.2023, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, informoi Komisionerin se:

“Në përgjigje të shkresës suaj, lidhur me rastin në fjalë ju informojmë se:

Këshilli Kombëtar i Mjekëve është i njohur me problemin e mjekëve specialistë mikrobiologë dhe këtë problematikë ja ka paraqitur Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga ana e Presidentit të UMSH-së, Dr. F. B.

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë nuk është faktor në përcaktimin dhe kategorizimin e pagave të mjekëve të përgjithshëm dhe atyre specialistë që punojnë në sektorin shëndetësor publik, qoftë edhe atë privat.”

- Me shkresën me nr. 3480/1 prot., datë 06.10.2023, MSHMS, informon Komisionerin se:

“Me VKM nr. 245, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr. 555, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë Përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin Përkatës”, të ndryshuar, paga e mjekut mikrobiolog është rritur në masën 7%, e njëjtë me rritjen e pagave për të gjithë punonjësit e sektorit të shërbimit të epidemiologjisë dhe shëndetit mjedisor në NJVKSH.

Me ngritjen e pretendimit nga ana e mjekëve mikrobiologë për rritjen e pagës së tyre, është mbajtur një takim me përfaqësues të tyre në Ministri, ku u vlerësua se për shkak se mjekët mikrobiologë përveçse ofrojnë ekspertizë teknike në testimet mikrobiologjike për popullatën, ofrojnë dhe shërbime mjekësore direkt me pacientin, iu komunikua se MSHMS, do të ndërmarrë hapat e duhur për rritjen e pagës së mjekut mikrobiolog në shërbimin e epidemiologjisë në NJVKSH.

Sa më sipër, me shkresën tonë me nr. 2833 prot., datë 25.07.2023, me lëndë “Propozim për disa rregullime dhe saktësime në Vendimin e pagave me nr. 555/2011, të ndryshuar, i jemi drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike, duke i dhënë propozimet tona, ndër të tjera, dhe për rritjen e pagës së mjekëve mikrobiologë pranë NJVKSH-ve. Puna për ndryshimin e VKM nr. 555/2011, të ndryshuar është në proces.”

Bashkëlidhur parashtrimeve nga ana e MSHMS, është depozituar në cilësi prove, kopje e shkresë me nr. 2833 prot., datë 25.07.2023, e MSHMS-së, me lëndë: *“Propozim për disa rregullime dhe saktësime në vendimin e pagave 555/2011, të ndryshuar.”*

2. Në zbatim të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, subjektet ankues janë njohur nga ana e inspektorit të çështjes, me qëndrimin e MSHMS-së dhe dokumentacionin e dërguar.
3. Në vijim të shkresës së MSHMS-së, grupi i mjekëve mikrobiologë pranë NJVKSH-ve, me shkresën me datë 17.10.2023 (protokolluar pranë KMD-së me nr. 1007/4 prot., datë 18.10.2023), ka dërguar parashtrime, duke cituar, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

“Megjithë përpjekjet e vazhdueshme të mjekëve mikrobiologë të NJVKSH-ve, për të zgjuar angazhimin dhe përgjegjësinë e instancave të ndryshme shtetërore, duke bërë evidente në mënyrë të vazhdueshme që nga periudha prill-shtator 2023, indinjatën dhe pakënaqësinë tonë për mosvlerësimin dhe lënien në harresë të kësaj kategorie mjekësh specialistë, sipas VKM nr. 245, datë 20.04.2023, në asnjë moment nuk morëm një përgjigje apo informacion se si po ndiqej apo procedohej me çështjen tonë, nëse do kishte një zgjidhje apo jo. Rikonfirmojmë se nuk morëm asnjë përgjigje me shkrim apo verbalisht për kërkesat, ankesat tona dhe nuk kemi patur asnjë informacion paraprak për këtë shkresë të MSHMS-së.

Me dëshirën për ta vlerësuar si një hap pozitiv këtë propozim të MSHMS-së, edhe pse e vonuar, kemi shumë paqartësi në lidhje me këtë ndërmarrje ndërinstucionale.

...Në gjykimin tonë zgjidhja e problemit të mjekëve mikrobiologë të NJVKSH-ve, nuk duhet të ishte pjesë e këtij propozimi në të cilin përfshihen dhe shërbime të reja.

Në momentin që specialiteti ynë përfshihet në kategorizimin sipas Udhëzimeve të Ministres së MSHMS-së, pra, në pozicione pune pranë Laboratorëve të Specialiteteve në Qendrat Shëndetësore, ku në fakt nuk ka asnjë Mjek Mikrobiolog dhe as Laboratorë të Mikrobiologjisë (një pozicionim i gabuar që vërteton moskuptimin ndërinstucional) do të mirëkuptonim dhe vlerësonim si një rrugë drejt zgjidhjes sa më të shpejtë e me më pak pasoja, një propozim nga MSHMS, për rialokimin e fondeve për trajtimin e mjekëve mikrobiologë pranë NJVKSH-ve, që nga hyrja në fuqi, me datë 01.04.2023, të rritjes së pagës.

Rritja e çmimeve, inflacioni, kriza ekonomike mbarëbotërore, janë fakte me të cilat përballemi çdo ditë dhe për ne, çdo vonesë përbën kosto financiare shtesë, madje njohja e situatës tonë nga të gjitha instancat ku jemi ankuar dhe lënia në harresë e kërkesës tonë, shton akoma më shumë diskriminimin ndaj kësaj kategorie mjekësh specialistë.”

4. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1007/5, datë 06.12.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 20.12.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi që gjatë seancës të depozitohet kopje e dokumentacionit, si më poshtë:

- *“Kopje të Relacionit shoqërues të VKM nr. 245, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr. 555, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë Përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Spitalin Përkatës”, objekt shqyrtimi pranë KMD-së.*
- *Nëse konkretisht ka masa të ndërmarra nga ana juaj, në kuadër të konsiderimit e zgjidhjes së kësaj problematike, lutemi të na vini në dijeni, duke bashkëlidhur dhe dokumentacionin respektiv.*
- *Bashkëlidhur mund të depozitoni çdo dokument tjetër që vlerësoni se ndihmon në sqarimin apo zgjidhjen e problematikës së ngritur.”*

5. Seanca dëgjimore u realizua me praninë e përfaqësuesve të subjekteve ankues, dhe në mungesë të përfaqësuesve të institucioneve të ftuara në seancë: Këshillit të Ministrave, MSHMS-së, OSHKSH-së, Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor dhe të NJVKSH-ve respektive.

Gjatë seancës përfaqësuesit e subjekteve ankues/grupit të mjekëve mikrobiologë, pranë NJVKSH-ve, mbajtën të njëjtin qëndrim si ai i komunikuar shkresërisht me KMD-në.

6. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 1007/7 prot., datë 26.12.2023, Komisioneri iu drejtua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Departamentit të Administratës Publike (DAP), lidhur me marrjen e informacionit se si është proceduar nga ana e tyre lidhur trajtimin e shkresës me nr. 2833 prot., datë 25.07.2023, të MSHMS-së, brenda kompetencave institucionale respektive.

7. Në përgjigje të sa më sipër, MSHMS⁵, nëpërmjet e-mailit datë 08.01.2024, informoi KMD-në se:

“Në lidhje me procedurën administrative të iniciuar me ankesën e mjekëve mikrobiologë pranë Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), bashkëlidhur gjeni, VKM-në nr. 794, datë 28.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, të ndryshuar. Nga këqyrja e VKM-së sipërcituar, konstatohet se pikën 1.2/c) në pjesën e dytë, “II. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor”, të kreut 1.2, pas rreshtit me numër rendor 14, shtohen rreshtat me numra rendorë 15,

⁵ Z. O. A, Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit, pranë MSHMS-së.

16 dhe 17, ku numri 17 i korrespondon mjekëve mikrobiologë që punojnë në shërbimet e shëndetit publik, pra, kategorisë ku përfshihen edhe subjektet ankues.

8. Një konfirmim i tillë është bërë edhe nga DAP-i, i cili, me shkresën me nr. 6456/1 prot., datë 09.01.2024, informoi Komisionerin, ndër të tjera se: *“Pas bashkërendimit të propozimit të MSHMS, midis DAP-it dhe MFE-së, projektvendimi u përcoll për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, dhe në dhjetor 2023 u miratua vendimi përkatës, ku një ndër ndryshimet e miratuara është edhe ndryshimi i pagave të mjekëve mikrobiologë, në NJVKSH-të, që është edhe objekt gjykimi pranë KMD-së.”*
9. Fakti i mësipërm, i është bërë i njohur subjekteve ankues nëpërmjet e-mailit nga ana e inspektorit të çështjes, duke i bashkëlidhur edhe aktet përkatëse shkresore.
10. Në vijim të sa më sipër, subjektet ankues/mjekët mikrobiologë pranë NJVKSH-ve, nëpërmjet e-mailit datë 17.01.2024⁶, kanë falenderuar Komisionerin për angazhimin e tij dhe punën e bërë për trajtimin e çështjes së tyre, dhe kanë paraqitur kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës pranë KMD-së, duke cituar ndër të tjera se: *“...Gjykojmë të drejtë tërheqjen e ankesës tonë pranë KMD-së, duke qenë se jemi të kënaqur me ndryshimin dhe përfshirjen tonë në VKM-në e ndryshuar me datë 28.12.2023.”*

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94⁷/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

⁶ Depozituar në dosjen e subjekteve ankues, në cilësi prove.

⁷ *“Tërheqja e ankesës”*.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjektet ankues, grupi i mjekëve mikrobiologë pranë NJVKSH-ve, të cilët, me anë të kërkesës datë 17.01.2024, janë tërhequr nga ankesa e tyre pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga subjektet ankues, nëpërmjet e-mailit datë 17.01.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 167 regj., datë 14.09.2023, të paraqitur nga subjektet ankues/grupi i mjekëve mikrobiologë pranë NJVKSH-ve, kundër Këshillit të Ministrave, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarohet të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 167 Regj., datë 14.09.2023, të grupit të personave/mjekë mikrobiologë pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), kundër Këshillit të Ministrave, për shkak se ankuesit janë tërhequr nga ankesa pranë KMD-së, duke konsideruar se është arritur efektiviteti për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA